

NEWSLETTER

Nëntor

Albsig, mbështet festivalin “Shekspiri zbret në Vlorë”, ngjarje e rëndësishme, duke i dhënë artit dhe kinematografisë rëndësinë e merituar.

Përkujtohet 25 nëntori, 20 Vjetori i Albsig: Një histori suksesi, besimi dhe përkushtimi.

Albsig, trajnim të dedikuar për sigurimin e Paneleve Fotovoltaike.
”Së bashku për të ardhmen e gjelbër”!

Panairi “Karta e Studentit”:
Një mundësi e re nga Albsig për studentët.

Albsig: Garanci e besueshme për komunitetin – Spitali i Pukës, rasti konkret.



PJESË E



KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP



Albsig, mbështet festivalin “Shekspiri zbret në Vlorë”, ngjarje e rëndësishme, duke i dhënë artit dhe kinematografisë rëndësinë e merituar.

Në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, i mbështetur financiarisht nga Albsig, organizohet për herë të parë në qytetin e Vlorës Festivali Ndërkombëtar i Shekspirit, titulluar: “Shekspiri zbret në Vlorë”, i cili u zhvillua nga data 9 deri më 13 nëntor 2024. Kjo ngjarje e veçantë synon të promovojë dhe të evokojë vlerat kulturore, duke ndikuar në konsolidimin e trashëgimisë kombëtare dhe duke përcjellë këto vlera të vyera tek brezat e rinj. Albsig, një prej kompanive kryesore të sigurimeve në Shqipëri, mbështet këtë iniciativë për të theksuar rëndësinë e vlerave kulturore në zhvillimin e një shoqërie të shëndetshme dhe të bashkuar. Përmes kësaj mbështetjeje, Albsig dëshmon angazhimin e saj për të mbrojtur dhe promovuar jo vetëm vlerat materiale, por edhe ato shpirtërore e kulturore, duke kontribuar për një shoqëri që i çmon dhe i zhvillon traditat e saj. Duke theksuar kështu edhe drejtuesit artistikë të festivalit të cilët përfshijnë figura të njohura të artit shqiptar si Timo Flloko (udhëheqës artistik), Ndriçim Xhepa (drejtor organizativ), dhe Kristaq A. Skrami (aktor dhe regjisor). Selektorët e festivalit janë Luiza Xhuvani dhe Rajmonda Bulku, aktore me përvojë, që do të ndihmojnë në përzgjedhjen e pjesëmarrësve.

Bashkia Vlorë dhe Qendra “Shakespeare & Summer School” dhe Teatri “Petro Marko” Vlorë organizojnë për herë të parë në qytetin bregdetar Festivalin Ndërkombëtar të Shekspirit. Projekti teatror ndërkombëtar “Shekspiri zbret në Vlorë” synon të evokojë dhe të orientojë ndikimin e vlerave dhe kulturave kombëtare në konsolidimin, mirëkuptimin dhe harmoninë që kombet kanë pasur mes tyre ndër shekuj. Dhe jo vetëm kaq por të transmetojë dhe t’i përcjellë këto vlera nëpërmjet krijimtarisë artistike dhe interpretimit aktorial tek artistët e rinj dhe brezat e rinj krijues, t’i inkurajojë dhe t’i stimulojë ata në mënyrën më krijuese të të menduarit. Përmes veprave të Shekspirit, festivalit do t’i shërbejë si një medium për eksplorimin e temave universale si dashuria, përpjekja për ëndrrat, konfliktet dhe pajtimet, të cilat janë gjithmonë të pranishme në shoqëri. Kjo panoramë do të inkurajojë brezat e rinj të reflektojnë mbi sfidat dhe mundësitë që i rrethojnë, duke i ndihmuar ata të kuptojnë se si arti mund të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve dhe në krijimtarinë e një ambienti harmonik. Në këtë mënyrë Shekspiri do të kontribuojë në ndërtimin e një kulture që vlerëson dhe promovon tolerancën, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar duke e bërë artin një forcë unifikuese për të gjithë ne.

○ Aktivitetet kryesore të projektit përfshijnë:

Një qasje ndryshe për artëdashësit vlonjatë. Çdo mbrëmje, në sallën e Teatrit “Petro Marko” do të shfaqen performanca të ndryshme sipas kalendarit të përgatitur me trupat pjesëmarrëse nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Italia. Këto shfaqje do të shoqërohen nga konferenca për shtyp, ku do të diskutohet mbi interpretimet dhe mesazhet artistike të çdo shfaqjeje, duke nxitur diskutime mbi rëndësinë e Shekspirit në botën e sotme. Simboli i festivalit do të jetë një bust i Shekspirit, i punuar nga studioja “Rira”. Ky bust do të jepet si kujtim për të gjitha trupat pjesëmarrëse dhe do të shoqërohet me certifikata për çdo aktor protagonist, si një simbol i vlerësimit për kontributin e tyre artistik. Festivali “Shekspiri Zbret në Vlorë”, mbështetur nga Albsig, premton të jetë një ngjarje e rëndësishme kulturore për qytetin, duke sjellë një frymë të re artistike dhe duke i bashkuar popujt përmes artit dhe vlerave universale të Shekspirit. Për Albsig, kjo mbështetje përbën një angazhim për të kontribuar në zhvillimin kulturor dhe për të nxitur ndërgjegjësimin mbi vlerat e qëndrueshme, duke promovuar një të ardhme ku kultura dhe solidariteti janë baza e shoqërisë.



Përkujtohet 25 nëntori, 20 Vjetori i Albsig: Një histori suksesi, besimi dhe përkushtimi

Nëntori sjell fetstat kuq e zi në Albsig. Krahas festave kombëtare në këtë muaj Albsig feston dhe përvjetorin e themelimit të saj. Konkretisht më datën 25 nëntor, Albsig shënon një moment të rëndësishëm në historinë e saj: 20-vjetorin e themelimit. Ky përvjetor simbolizon më shumë se një rrugëtim kohor; është dëshmi e përkushtimit të vazhdueshëm për të ofruar produkte dhe shërbime të sigurimit me standarde të larta dhe për të ndërtuar besim tek mijëra klientë në mbarë Shqipërinë.

Një udhëtim i pasionit dhe profesionalizmit nga stafi Albsig.

E themeluar në vitin 2004, Albsig nisi si një vizion për të krijuar një kompani që do të ofronte mbrojtje financiare për qytetarët dhe bizneset në Shqipëri. Sot, ky vizion është kthyer në realitet, duke u bërë një nga kompanitë më të besueshme dhe të respektuara në tregun shqiptar të sigurimeve. Gjatë këtyre dy dekadave, Albsig ka përballuar sfida të ndryshme dhe ka shënuar arritje të jashtëzakonshme, duke mbetur gjithmonë e përqendruar në inovacion dhe përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve.

Përgjatë këtyre 20 viteve, janë stafi i Albsig ata që kanë bërë diferencën. Një ekip profesionistësh të përkushtuar, të cilët me pasionin dhe përvojën e tyre, kanë ndërtuar themelet e forta të kompanisë. Brenda këtyre zyrave, më shumë se sa një vend pune, është krijuar një familje e madhe, e cila ka ndarë jo vetëm sukseset, por edhe sfidat e përbashkëta. Ku përmes një kalvari mesazhesh të gjithë "nismëtarët" e parë të Albsig në fillimet e saj, tashmë i shikon në mesomoshë të stabilizuar për jetën dhe të motivuar për punën.



25 nëntori një ditë përkujtimore plot emocion.

Ky përvjetor nuk është thjesht një festë, por një moment reflektimi dhe falënderimi. Në ambientet e zyrave të Albsig, më 25 nëntor, do të zhvillohet një event i veçantë për të përkujtuar këtë rrugëtim të jashtëzakonshëm. Stafi i kompanisë, menaxherët dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në suksesin e Albsig do të mblidhen për të ndarë kujtime dhe për të shprehur mirënjohjen për rrugën e përbashkët. Ky aktivitet do të shërbejë jo vetëm si një retrospektivë për arritjet e së kaluarës, por edhe si një pikënisje për sfidat dhe sukseset e së ardhmes.

Duke festuar këtë 20-vjetor, Albsig nuk ndalet këtu. Kompania mbetet e angazhuar për të sjellë risi në tregun e sigurimeve, për të zgjeruar më tej shërbimet dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit. Me të njëjtin përkushtim dhe vlera që e kanë karakterizuar që nga dita e parë, Albsig do të vazhdojë të jetë një partner i besueshëm për qytetarët shqiptarë. Në këtë përvjetor të rëndësishëm, Albsig dëshiron të shprehë mirënjohjen më të thellë për të gjithë klientët, partnerët dhe, mbi të gjitha, për të gjithë punonjësit që kanë qenë pjesë e këtij rrugëtimi. Kjo histori suksesi është histori e përbashkët, dhe së bashku do të ndërtojmë një të ardhme edhe më të ndritur.





Albsig, trajnim të dedikuar për sigurimin e Paneleve Fotovoltaike. “Së bashku për të ardhmen e gjelbër”!

Albsig, trajnim të specializuar për stafin nga ekspertë të Aon Reinsurance Solution.

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve dhe përshtatjes me kërkesat e tregut, Albsig organizoi një trajnim të specializuar për stafin, në bashkëpunim me Aon Reinsurance Solutions, një emër i njohur në zgjidhjet globale të risigurimit. Ky trajnim u përqendrua te siguri i paneleve fotovoltaike, një sektor me potencial të madh për zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë në Shqipëri. Ekspertët nga Aon ndanë njohuri të vlefshme dhe praktika më të mira ndërkombëtare për analizimin dhe menaxhimin e risqeve të lidhura me këtë teknologji. Gjatë trajnimit, stafi i Albsig pati mundësinë të diskutojë mbi metodologji të reja për vlerësimin e rreziqeve dhe mbi procedurat për përmirësimin e procesit të sigurimit të këtyre produkteve të reja.

Panelet fotovoltaike janë një hap i rëndësishëm drejt energjisë së rinovueshme në vendin tonë, dhe Albsig, duke synuar të jetë lider në sektorin e sigurimeve, ka vendosur të përfshihet aktivisht në këtë fushë të re. Trajnimi shërbeu si një platformë për të ndërtuar kapacitete të reja dhe për të përshtatur produktet e sigurimit me standardet dhe praktikatat më të avancuara në nivel global. Përmes kësaj iniciative, Albsig dëshmon edhe një herë angazhimin e saj për zhvillimin profesional të stafit dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në promovimin e energjisë së gjelbër dhe të qëndrueshme në Shqipëri. Bashkë me partnerët ndërkombëtarë, Albsig vazhdon të jetë një hap përpara në ofrimin e zgjidhjeve inovative që i përgjigjen kërkesave në rritje të klientëve dhe tregut shqiptar.





Panairi “Karta e Studentit”: Një mundësi e re nga Albsig për studentët.

Agjencia e Rinisë ka organizuar panairin “Karta e Studentit”, i cili u zhvillua më datë 26 Nëntor, nga ora 08:30 deri në 12:30, në oborrin e Universitetit Politeknik të Tiranës, duke u shtrirë deri në Sheshin “Nënë Tereza” ku mori pjesë edhe Albsig, pjesë e Kastrati Group. Ky event është pjesë e një nisme më të gjerë për të mbështetur studentët dhe për të promovuar bizneset partnere që ofrojnë përfitime dhe zbritje për mbajtësit e Kartës së Studentit. Albsig ka qenë dhe do të mbetet kompania që mbështet gjithmonë brezat e rinj në rrugëtimin e tyre drejt profesionit. Sipas organizatorëve panairi synon të krijojë një platformë interaktive ku studentët mund të njihen me ofertat dhe shërbimet e ndryshme që ofrohen nga bizneset lokale. Karta e Studentit, e njohur tashmë si një instrument i rëndësishëm mbështetës për rininë, siguron akses në shërbime dhe produkte me çmime të reduktuara, duke ndihmuar kështu studentët në përballimin e kostove të përditshme.

Pjesëmarrja e Bizneseve Partnere

Në këtë event morën pjesë një numër i konsiderueshëm biznesesh partnere të Agjencisë së Rinisë, të cilat prezantuan shërbimet dhe ofertat e tyre ekskluzive për studentët. Bizneset pjesëmarrëse përfshijnë sektorë të ndryshëm, si teknologjia, libraritë, shëndeti, ushqimi, sigurimet, transporti dhe argëtimi. Një ndër bizneset që ka mbështet projektin “Kartës së Studentit” është dhe shoqëria e sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, ku kjo e fundit numëron me dhjetra aktivitete të mbështetura vetëm për studentët në fusha të ndryshme.

Pse është e rëndësishme pjesëmarrja e Albsig?

- Për studentët: Një mundësi për të eksploruar ofertat dhe përfitimet e Kartës së Studentit, si dhe për të krijuar kontakte të reja me Albsig.
- Për Albsig: Një hapësirë për të promovuar shërbimet dhe për të ndërtuar marrëdhënie të reja me komunitetin studentor. Agjencia e Rinisë thekson rëndësinë e konfirmimit të pjesëmarrjes për të siguruar një organizim sa më efikas dhe të suksesshëm. Panairi ishte i hapur për të gjithë studentët e interesuar. Ky event pritet të jetë një mundësi e shkëlqyer për të forcuar bashkëpunimin midis studentëve dhe bizneseve, duke kontribuar në krijimin e një komuniteti më të lidhur dhe më të mbështetur.





Albsig: Garanci e besueshme për komunitetin — Spitali i Pukës, rasti konkret.

Ditët e fundit, qyteti i Pukës u përball me një stuhi të fortë që shkaktoi dëme të mëdha në infrastrukturë, duke përfshirë edhe spitalin e qytetit veriorë. Stuhia e fuqishme jo vetëm që shkatërroi çatinë e spitalit, por krijoi edhe rrezik për pacientët dhe stafin, duke detyruar autoritetet të kryejnë evakuimin e menjëherëshëm të pavioneve.

Fatmirësisht, nuk pati dëme në njerëz, por ndërhyrja e menjëhershme për rikonstruksion ishte jetike për rikthimin e situatës në normalitet e duhur. Për këtë u bë e mundur prezenca e menjëhershme e grupit të punës së shoqërisë së Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati group, për të rindërtuar dëmin e shkaktuar nga avaria e motit, pasi fatmirësisht spitali i qytetit të Pukës ishte i siguruar në Albsig.

Albsig: Mbrojtje dhe përgjegjësi sociale

Spitali i Pukës është i siguruar nga Shoqëria e Sigurimeve Albsig, e cila veprimi me shpejtësi duke aktivizuar menjëherë protokollin e saj të emergjencës. Albsig mori përsipër të gjitha shpenzimet për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga stuhia, përfshirë rikonstruksionin e çatisë dhe riparimet e tjera të nevojshme. Ky reagim i shpejtë tregon qartë përkushtimin dhe seriozitetin e kompanisë për të mbështetur të siguarit e saj në situata të vështira. Meqë jemi dhe në muajin nëntor, mjaftojmë të rikujtojmë përvojën e dy tërmeteve të vitit 2019, ku Albsig veprimi në kohë rekord dhe kundrejt standarteve të përcaktuara për çdo klientë duke i dëmshpërblyer për çdo dëm të ndodhur.

Punime në kohë rekord, pavarësisht kushteve


Spitali i Pukës së shpejti do t'i kthehet normalitetit po tashmë në kushte optimale. Pavarësisht motit të vështirë, punimet për rikthimin e çatisë së spitalit kanë avancuar me ritme të shpejta, duke siguruar që spitali të rikthehet në funksion sa më parë. Albsig ka treguar njëherazi profesionalizëm dhe përgjegjësi të lartë sociale, duke garantuar jo vetëm përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, por edhe ndërhyrje të menjëhershme për të siguruar që komuniteti i Pukës të mos mbetet pa mbështetjen e duhur shëndetësore.

Një provë e qartë e besimit dhe cilësisë

Ky rast shërben si një tjetër provë e qartë e cilësisë dhe garancisë që ofron Albsig, pjesë e Kastrati Group, për të gjithë të siguruarit e saj. Kompania nuk është thjesht një ofrues shërbimesh, por një partner i besueshëm që qëndron pranë klientëve në çdo situatë. Përmes kësaj ndërhyrjeje të shpejtë, Albsig dëshmon se është më shumë sesa një kompani sigurimesh — është një institucion që investon në sigurinë dhe mirëqenien e komuniteteve.

Në një treg ku besimi dhe përgjegjësia janë thelbësore, Albsig vazhdon të jetë një emër që përfaqëson stabilitet dhe siguri, duke kontribuar në rindërtimin dhe mbështetjen e institucioneve vitale, siç është rasti i spitalit të Pukës. Kjo është një dëshmi e fuqisë së bashkëpunimit të qëndrueshëm midis biznesit dhe komunitetit, duke ndërtuar një të ardhme më të sigurt për të gjithë.





 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL